



Kuvendi

01.Nr.II-të Publike

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e II-të publike të Kuvendit, me dt.21.12.2023.

Sot me datë: 21.12.2023, u mbajt Takimi II-të Publik me qytetarët e Komunës së Deçanit.

Pjesëmarrës: 14 asamblist, Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, Drejtor të drejtorive Komunale (10), OSBE.

Në mbledhje ishin prezent gjithsejtë 88 qytetarë nga të cilët, 27 ishin femra dhe 61 meshkuj.

Takimin publik e kryesoj dhe e udhëhoqi, Kryesuesi i Kuvendit, z. Hajdar Sutaj.

Rendi i punës:

Takimi II-të Publik me qytetarët e Komunës së Deçanit.

Kryesuesi i kuvendit komunal, Hajdar Sutaj, bëri hapjen e Debatit Publik në te cilën hapje i kaloj fjalën Kryetarit të komunës z. Bashkim Ramosaj.

Kryetari i Komunës: përshëndet të gjithë të pranishmit, pastaj shton se prezent jemi në fund vit sipas obligimit ligjor jemi te obliguar për raportim të punës për vitin 2023, komuna ka operuar me buxhet prej 13,145,233.46 milion euro nga buxheti janë: 6,584,934.34 milion euro paga dhe shtesa për paga, 4,023,969,05 milion euro investime kapitale, 3,791,534.07 milion euro projekte apo filluar 32 projekte me kapacitete buxhetore gjithashtu edhe projektimi i këtij buxheti ishte ky qëllimi i investimit kapital dhe kërkesa agjencioneve të ndryshme për mbështetje të këtij buxheti ku janë edhe ministrit e linjës dhe të buxhetet e nivelit ndërkombëtar.

Besoj se për të gjithë qytetarët e Komunës së Deçanit, janë në njohuri për zhvillimin e të gjitha punëve dhe grupet e interesit si OJQ-të, klubet sportive, mbështetja për ndihmë mjekësorë gjithashtu edhe studentet, shpesh në diskutime qe kemi bërë në institucion (komunë) jemi ende larg për krijimin e një standardi tjetër ku nuk do të filet për asfaltime, kanalizime, elektrifikim etj. ku është një pengës për realizimin e të gjitha kërkesave te qytetarëve, përtej kësaj vlerësoj dhe besoj se i është dhënë një koncept i qartë për ecjen para të kësaj komune, për kanalizim, trotuare ,ndriçim publik mund t'a quajmë koncept të zhvillimit ekonomik është kohë e gjatë të folët për të gjitha projektet dhe fazat ku disa janë përfunduar dhe disa për shkak të buxhetit nuk kanë mundur të përfundohen ne si ekzekutiv jemi të gatshëm për çdo pyetje nga te gjithë te pranishmit-qytetarët.

Kryesuesi i kuvendit komunal Hajdar Sutaj, i japë të drejt çdo pjesëmarrësi në takim dhe shpall të hapur debatin.

1. Gezim Bojkaj, përfaqësues i fshatit Isniq, shprehim shqetësimin për ndërtimin e 4 (katër) urave që lidhin me bjeshkët tona ndërsa të projektet buxhetore për vitin 2024, si përfaqësues i fshatit Isniq kemi një listë me disa kërkesa siç janë: 1. ndërtimi i urës dhe kanali në qendër të fshatit Isniq; 2. ndërtimi i rrugës nga fshati drejt shkollës fillore; 3. ndriçimi publik i fshatit vazhdimi dhe ndërtimi i poqave elektrik të ndriçimit publikë; 4. Zgjidhje e çështjes së Pallatit të Kulturës me rryme; 5. rregullimi i formës së mirëmbajtjes së dy shesheve "Isa Boletini" dhe "Rrustem Bruqi" dhe varrezat e fshatit; 6. Punimi i kanalizimit të ujërave të zeza dhe 7. ndërtimi i qerdhës edhe pse kam disa informata që e kemi miratuar për ndërtim mirëpo deri me tani ska asgjë.
2. Hasan Lokaj, fshati Sllup kam dy kërkesa apo dy projekte që janë dhe janë ndalë se punuari po me intereson kryetar a ka ndonjë nismë për ujësjellësin e regjionit të Vokshit i cili nuk është duke funksionuar me ndriçim publik ka 2 vite që është ndërtuar mirëpo 90 %, nuk funksionojnë, desha të ju pyes për ujësjellësin ose se ku mund të drejtohem si rekomandim a të drejtohem diku tjetër apo a kemi një listë a është cilësia e dobët e rrymës apo çka është sepse ndriçim nuk ka.
3. Blerim Kadrijaj, zëvendës përfaqësueses i fshati Rastavicë, kemi një kërkesë përderisa nuk kemi përfunduar me një fatalitetet për urën në fshatin tonë.
4. Shaqir Daci fshati Irzniq, kur kemi ndonjë kërkesë kemi dëshirë të kemi edhe përkrahje.
5. Idriz Cacak, nga Deçani, kanalizim nuk posedojmë si shtëpi individuale, kisha pas dëshirë një përgjigje rruga që është shtruar deri të restorant Maturanti nuk ka kanalizim.

Përgjigjet e Kryetarit të komunës, për pyetjet e lartë cekura nga qytetaret, po fillojmë nga përfaqësuesi i fshatit Isniq. Gezim Bojkaj, i cili është drejtua edhe me një shkresë për shumë tema që realisht janë preokupim i këtij lokalitet duke filluar nga ndërtimi i urës e cila është pastruar disa here mirëpo nuk funksionin për shkak të ndërtimit të dobët, shpresojmë që sa më shpejt do të ndërtohet, ndriçimi publik sa i përket kemi qen në takime ku ne si komune kemi bërë një dosje shumë të veçantë për ndriçim publik dhe si rrjedhojë janë me tepër se 3 apo 4 vite për investime ku nga shtatori 20 kamion janë për ndërtim të ndriçimit publik është obligim i komunës së pari mendojmë rrugët kryesore të përfundohen pastaj rrugët sekondare si projekte po ec mirëpo për shkak të buxhetit nuk kemi mundur të përfundojmë si qeshtje, ndërsa të salla e kulturës në Isniq kemi pas shumë shpenzime që janë bërë ndërsa të rregullimi ose mirëmbajtja qoftë e varrezave qoftë e shesheve Ndërmarrja "Higjiena" i mirëmban kemi pas edhe një kërkesë të veçantë nga fshati Isniq, të cilët kanë kërkuar për një tarifë për mirëmbajtjen e varrezave ku është një kontratë me Ndërmarrjen "Higjiena" për mirëmbajtje, ndërsa të asfaltimi ne kemi një pjesë të vendbanimeve ku edhe ende s'kemi arrit të përfundojmë e cila ka ardhë si rrjedh për mos përfundim ku ende ka disa fshatra të pa përfunduar ku ne të cilën është një kontratë 3 vjeçare ku

janë përfunduar fshatrat: Shaptej, Dubovikë dhe Strelc i Eperm, por ende s'kemi mundur të përfundojmë rrugët Ratish dhe disa pjesë të fshatrave tjera janë ende të pa përfunduara me asfaltim, ndërsa sa i përket kanalizimit mund të bëjmë projekte dhe kemi lobuar mirëpo nuk mund të marrim investimin me buxhet të komunës për kanalizim e cila vlerë është 30 milion euro sepse fshatrat: Isniq, Prapaqan dhe Dubovikë duhet të ndërtohet një impiant me standard pastaj regjioni i Vokshit e deri të Jasiqi i Ri ku janë pa kanalizim ku disa janë investim nga vet qytetaret ku nuk janë përfundimtare fatkeqësisht ka pas marrëveshje e cila marrëveshja e parë ka dështuar implementimi i kësaj pjese të dytë të një memorandumit të vitit 2021, besoj se edhe kjo temë do të përfundohet.

Mirëpo keni parasysh se komuna nuk e bën ndonjë ndarje kur e shpërndan buxhetin sipas numrit të shtëpive apo banoreve si parim buxheti ndahet sipas nevojave që kanë vendbanimet, ndërsa sa i përket pyetjes së Hasan Lokaj për ujësjellës nuk është përgjegjësi e komunës është përgjegjësi e jona që të kërkohet raport dhe takime për defektet kemi kërkuar për menaxhim ujësjellësin mirëpo si e tillë është kompania rajonale Dega në Deçan, a do të ishte mirë që të marrim në menaxhim mirëpo nuk ka gatishmëri nga ana e tyre ku edhe para 2 viteve ka qenë rregullimi dhe vendosja e orëve dhe trajtimi me i ndershëm mirëpo nuk kemi has në miratim tani kemi nënshkruar një marrëveshje për vendosjen e orëve duke mos cenuar banoret, nuk është nën përgjegjësinë tone kemi bërë përpjekje [për menaxhim mirëpo nuk na lejohet deri sa politikën të jenë me efikasë.

Të Blerim Kadrijaj, ju uroj për iniciativat të cilat edhe shihen sa i përket urës së fshatit Rastavicë, është një urë problematike që është raportuar kohë pas kohe mirëpo që ende se kemi pas mundësinë për reagim mirëpo që nga Jasiqi i Ri deri në fshatin Prilep, do të rregullohet sa i përket "Lagjes së Dëshmoreve" apo Pemishtes besoj që kemi investuar deri diku për t'a qofte me shtylla elektrike dhe asfaltin.

Në Irzniq ndoshta është nga vendbanimet si me punëtor në aspektin bujqësor besoj që vitin e ardhshëm do jemi me ne kohë të përmirësimit si standard sidomos në sektorin e kësaj ane bujqësinë.

Pyetja e fundit nga Idriz Cacaj, që potencoj kanalizimin edhe kur janë punuar rrugët si në qendër dhe problemet e juaja varet shumë nga ju sepse nuk ka dakordim nga vetë qytetarët për përfundimin e këtij kanalizimi mirëpo buxheti për vitin 2024, do të implementohet nëse ju si banor do të keni një zgjidhje të këtij problemi sepse deri me sot janë 18 konteste vetëm për vendosjen e shtyllave elektrike kemi konteste të ndryshme si rrugë kanalizim etj.

Lagja e Dëshmoreve problemi është sepse kur ka reshje është se behet grumbullimi i ujit.

Fadil Dervishaj, është pyetja për rrjetin elektrik sepse shtyllat janë të dobëta kemi bërë ankesë mirëpo s'kemi përgjigje se di sa mund të ketë ndikim komuna të KEDSI.

Kryetari i komunës, mund të japë një sqarim edhe nga unë dhe nga kryetaret tjerë ku ne i kemi 2 dosje të caktuara një është për të gjitha vendbanimet ku një staf ka bërë incizimin ku kjo dosje ka shkruar në Zyrën e Rregullatorit Energjetik- ZRE dhe KEDS ku operojnë nga këto kërkesa ku kanë me filluar nga fshati Kodrali në drejtim të fshatit Irzniq, kemi në disa zone shumë probleme sipas banoreve se ku të vendosen shtyllat.

Hasan Lokaj sa i përket ujësjellësit e ceka se shtyllat janë mirëpo poqët elektrik nuk funksionojmë mbi 90 %, ku duhet bere kërkesa tek komuna apo tek kompania.

Kryetari i komunës, besoj qe u përgjigja edhe me herët për ndriçim jam me tepër se 10 vendbanime për t'u lëshuar ndriçimi ku ende nuk është një kabull për funksion ne ketë fazë është edhe fshati Sllup.

Beqir Kuçi, kryetar i këshillit të Deçanit, një qeshtje për Deçanin kisha pyetja qka po behet me "Podin e Gështenjës" rrugën si mund të behet zgjidhje, shkolla fillore "Lidhja e Prizrenit" ku nuk ka asnjë punim ne ketë vit ku aty është ajo vrazhdësi mos të shikohet.

Kryetari i komunës, ndoshta po e japi një përgjigje duke filluar nga shkolla ju e dini qe ne vitin 2018 dhe 2019 kemi filluar me 8 shkolla për ndërtim ndërsa në 10 shkolla kemi filluar me efqienc të shkolla "Lidhja e Prizrenit" qe ka mbet në gjysë ka qen një debat pse ka ngec puna ne kemi qen të gjithë të lumtur kur ka filluar mirëpo ne ndonjë here nuk kemi pas fat sa i përket kompanive e cila shumë është shfrytëzuar 20 %, të inflacionit ku askush se ka rimbursuar mirëpo kontrata ende nuk është shkëputur me kusht qe t'i ipet një tender tjetër ku i njëjti fat ishte edhe me rrugën Deçan – Plavë, besoj se do të vij fundi dhe besoj qe vitin qe vjen do të jetë në funksion sepse janë përfunduar 7 shkolla dhe 10 me efqienc tek "Podi i Gështenjës" është problem politik, administrativ dhe gjyqësor ku një problem se dimë ka të fillojmë edhe ne rast se iniciojmë për ndarje do të krijohet problem për shkak të pronareve qe kanë fituar pronësi sipas trashëgimisë ka njerëz qe po drejtohen në gjykatë për fitim te kësaj të drejte.

Brahim Vishaj, nga fshati Kodrali me vendbanim në Deçan, kamë 2 ;preokupime qe do t'i parashtroj e para për kryetarin dhe e dyta për drejtorin e bujqësisë.


Rruga e cila është ndërtuar nga Lëbusha, deri të ura e "Bajram Hasanve" pyetje për kryetarin është trotuarin i cili është i ndërtuar ne mënyrë shume profesional a është i ndërtuar për qytetar këmbësor apo vetura, ndërsa pyetja për drejtorin e bujqësisë, komuna e Deçanit njihet për prodhimtari a ka ndonjë përmirësim në zhvillimin e kullosave pre bletari ku në Deçan është kolaps pre kullosa me arsytim sepse toka nuk punohet fare dhe nëse nuk merret diçka parasysh për ketë lëmi besoni qe bletaria në Deçan, nuk do të ekzistoj gjatë kullosjes se gështenjës ku po arrin numër i madh qe nuk ka kapacitet, bletaria ne Deçan arrin diku 7000 koshere ku në Deçan, po grumbullohet një numër i madh i koshereve nga anët tjera apo jashtë Komunës së Deçanit.

Kryetari i komunës, puna është qe kur është dizajnuat është menduar qe njëra korsi te është për parking, po besojmë qe mbas një kohe edhe shtëpitë qe janë afër rrugës dhe bizneset do të krijojnë kushte për parkingje, edhe për beltarin marr fjalën sepse shoqata në Deçan, ka pasur mbështetje dhe subvencionim dhe është ne dorën tuaj qe të nënshkruhet një vendim dhe të vendoset për kullosat në Deçan, për kullosat nga anët tjera sepse të paktën edhe nëse dikush vendos për kullosa të ketë një certifikatë nga mjeket ku kemi pas raste edhe për bartje të sëmundjeve të ndryshme.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë dhe e shpalli të mbyllur takimin.

Procesmbajtëse:

Dyke Lllolluni



Kryesues i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

